

KONTRATA

Me datë _____ në mes të:

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, rruga: UÇK 2, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëri anë dhe

Dhe **N.P.T"Arhing"** nga Prishtina, adresa 38 /A Bil Klinton, me numër të regjistrimit të biznesit 810344995 dhe me numër fiskal 6000136859 përfaqësuar nga Jeton Canhasi – Drejtor në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

TITULLI I KONTRATËS:

Realizimi I matjeve gjeodezike incizimit të ndërtesave pa leje, për përfituesit e ndihmës sociale

Nr. i Prokurimit ¹	616-19-3114-2-3-6
Nr i brendshëm	616 19 092 236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Realizimi I matjeve gjeodezike incizimit të ndërtesave pa leje, për përfituesit e ndihmës sociale**

1.2 Kontrata hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të kontratës

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Prishtine

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **[1,156.00] €; [njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë Euro]**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **[furnizimeve]** **[shërbimeve]** **[punëve]** duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqip* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	<i>NEKIMU TOKO W</i>	Emri:	<i>ARBËR GANTHARI</i>
Pozita:	<i>E. i prokurimit</i>	Pozita:	<i>MENAXHER</i>
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	<i>03.07.2019</i>	Data:	<i>03.07.2019</i>
Vula:		Vula:	<i>ARHING</i>



Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

DETYRA PROJEKTUESE

Realizimi i matjeve gjeodezike/incizimit të ndërtesave pa leje, për përfituesit e ndihmës sociale, me qëllim të legalizimit të tyre.


Për legalizimin e ndërtesave pa leje të rasteve sociale, Komuna e Prishtinës ka ndarë mjete për ti mundësuar kësaj kategorie legalizimin e shtëpive.

1. Matja / Incizimi gjeodezik i ndërtesave (shtëpive)

- Rilevimi gjeodezik i planit të parcelës (duke përfshirë edhe pikat e kyçjes në ujësjellës, kanalizim, furnizim me energji elektrike),
- Matja gjeodezike e objektit - ndërtesës (pasqyrim tridimensional - gjeometria e ndërtesës x, y, h)
- krijimi i skicave për secilin kat - bodrumit, perdheses dhe kateve të ndertimit.
- krijimi i regjistrit të fletparaqitjes për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesës
- të nderhyrjet pa leje në ndertimet me leje, incizimi bëhet për pjesën nderhyrjes duke e evidentuar me shtresë të veçantë.

2. Forma sipas të cilës duhet të dorëzohen matjet

- Të matet baza e ndërtesës (footprint) së paku me 3 pika në skajet e objektit, ku dy nga këto pika e definojnë brinjën më të gjatë të objektit. (shiko skicat)
- Matja bodrumeve bëhet njëjtë sikur matja e bazës së objektit por duhet të definohet në shtresën përkatëse
- Të bëhet matja e fronteve të ndërtesës për brinjët të cilat nuk maten direkt me instrument
- Të maten pika të mjaftueshme në kulmet o objekteve për të rekonstruktuar edhe dimensionin e trete (shiko skicet).
- Të fotografohet dhe të krijohet nga një skicë për secilën ndërtesë të matur
- Duhet të mbledhen atributet për ndërtesat dhe të numerohen katet $-X+P+X+PF(PH)$.



3. Inçizimi i infrastrukturës :

- **Pusetat**

Bëhet inçizimi gjeodezik i mesit te kapakut te pusetes:

- Puset kanalizimi
- Puset drenazhuese
- Puset ujësjellësi
- Hidrant
- Puset termokosi
- Puset PTK
- Puset Elektrike, etj.


- **Shtyllat e ndryshme (elektrike, telefonike,apo ndriqimit)**

- Bëhet inçizimi gjeodezik i mesit te diametrit të shtyllës.
- X, Y, Z, Kodi, Atributi

- **Rrugët**

- Inçizimi i rrugëve dhe trotuarëve
- Shtigjet në kuadër të parcelës kadastrale
- X, Y, Z, Kodi, Atributi

Numri i Prokurimit: 616 19 092 236– Titulli Realizimi I matjeve gjeodezike incizimit të ndërtesave pa leje, për përfituesit e ndihmës sociale



Skica

4. Kërkesat e përgjithshme

Për realizimin e këtij projekti, kompania kontraktuese është i obliguar:

- Të siguroj koordinatat (Y, X, Z) për rrjetin gjeodezikë referent nga Agjensioni Kadastral i Kosovës, (me foto, skicën e matjeve, koordinatat (Y, X, Z) në Kref01);
- Te gjitha matjet duhet te behen konform udhezimeve dhe manualeve te punes duke perdorur kodet dhe attribute per cdo pike te matur apo te dhena te plotesuara.
- Te dhenat duhet te organizohen ne shtresa:

NR	Emri i shtresës	Kodet
1	Pike_Kanlizimi_Simbol	PKF
2	Pike_Ujesjellesi_Simbol	PU
3	Pike_Ptk_Simbol	PTK
4	Pike_Termokosi__Simbol	PTE
5	Pike_Kek_Simbol	PKE
6	Pike_Interneti_Simbol	PIN

Numri i Prokurimit: **616 19 092 236**– **Titulli Realizimi I matjeve gjeodezike incizimit të ndërtesave pa leje, për përfituesit e ndihmës sociale**

7	Pike_Hidrant__Simbol	PHY
8	Pike_Ujemates__Simbol	PUM
9	Pike_Drunje_Simbol	PDR
10	Pike_Kanlizimi_Atmosferik_Simbol	PKA
11	Pike_Shtylle_Telefoni_Simbol	PST
12	Pike_Ujembledhes_Simbol	PUB
13	Pike_Shtylle_Elektrike_Simbol	PSE
14	DTM_Modeli_Terenit	ska
15	Pike_lartesi_Objekti_Kulm	01
16	Siperfaqe_Gjelberimi	02
17	Muri_Mbrojtes	03
18	Ndertesa_Kioske	04
19	Ndertesa_Afarizem	04
20	Ndertesa_Arsimi	04
21	Ndertesa_Garazhe	04
22	Ndertesa_Garazhe_Publike	04
23	Ndertesa_Fetare_Xhami/Kishe	04
24	Ndertesa_Haustor	04
25	Ndertesa_Institucione	04
26	Ndertesa_Ndihmes	04
27	Ndertesa_Plato	05

Numri i Prokurimit: **616 19 092 236**– **Titulli Realizimi I matjeve gjeodezike incizimit të ndërtesave pa leje, për përfituesit e ndihmës sociale**

28	Ndertesa_Shendetesia	04
29	Ndertesa_Shtepi	04
30	Ndertesa_Strehimore	04
31	Ndertesa_Terese	04
32	Ndertese_Bazament_Betoni	04
33	Ndertese_Trafostacion	04
34	Numrimi_Katet_TXT	04
35	Numrimi_Objektit_TXT	04
36	Objekt_per_Mbeturina	04
37	Pika_Detaje	ska
38	Puset_Korniza_Beton	06
39	Rethoje_Muri	07
40	Rethoje_Metalike	08
41	Rrethoje_Teli	09
42	Rrjeti_3rnd	Kodi sipas AKK
43	Rruga_Asfalt	10
44	Rruga_Zhavor	11
45	Rruga_Kubeza_Betoni	12
46	Rruga_Skajor	13
47	Shrafura	14
48	Stazat	15

Numri i Prokurimit: **616 19 092 236**– **Titulli Realizimi I matjeve gjeodezike incizimit të ndërtesave pa leje, për përfituesit e ndihmës sociale**

49	Stazat_Shkallore	16
50	Terasa	17
51	Terrene sportive	18
52	Trotuar	19
53	Bazament_Pusete_Beton	20

Ne rast të identifikimit të informatave në terren të cilat nuk mund të futen në ndonjeren nga shtresat, ato duhet të shtresohen në bashkepunim me mbikqyrësin.

5. Dorëzimi i të dhënave

Dorëzimi i të dhënave do të bëhet sipas planit detaj të punës të aprovuar nga punëdhënësi.

Te dhënat e krijuara nga tereni duhet të dorëzohen në afate dy javore në xlsx, shp dhe dwg dhe duhet të reflektojnë planin dinamik.

Formati i dorëzuar i të dhënave duhet të jetë:

5.1. Te dhënat në kopje fizike:

- Manuali i matjeve gjeodezike për të gjitha etazhet.
- Situacioni i terrenit me të gjitha matjet e realizuara në kuadër të parcelës sipas kërkesës në pikë 1 të kësaj detyre projektuese.
- Hartat apo Skicat e terrenit të cilat janë përdorur gjatë punës në terren.

5.2. Te dhënat në kopje digjitale

	Të dhënat që duhet dorëzuar	Formati
1	Dosjet e matjeve fillestare (origjinale)	Në varësi të instrumentit, Gsi, Idx, dbx.
2	Të dhënat për grafike në 2D	Cad, Shape, Pdf
3	Koordinata e pikave me attribute (x, y, z, kodi)	xls, txt


Numri i Prokurimit: 616 19 092 236– Titulli Realizimi I matjeve gjeodezike incizimit të ndërtesave pa leje, për përfituesit e ndihmës sociale

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [N.P.T. "ARHING"] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin III.1 të Informacionit për Tenderuesit, dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbytësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	N.P.T. "ARHING"
Adresa e plotë:	Rr. Bill Clinton 292, 10000 Prishtine, Kosove
Përfaqësuar nga:	
Emri	Arber Canhasi
Pozita	Menaxher
Nënshkrimi	
Data	05.06.2019
Vula	

Pjesa II. PERSHKRIMI I CMIMEVE

LLOJI I MATERIALIT	Njësia matëse	Sasia	Cmimi njësi me tvsh	Cmimi Total
e gjeodezike	m ²	4,000	€ 0.2890	€ 1,156.00